# AMBASADA E PARË E FËMIJËVE NË BOTË – MEGJASHI 1992-2022

## Për Ambasadën

Ambasada e parë e fëmijëve në botë-Megjashi është themeluar më datë 29 prill 1992 në Shkup dhe është organizata e parë qytetare e regjistruar për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve në Republikën e Maqedonisë, me vizionin - Një botë më të drejtë për çdo fëmijë!

Si një nga organizatat e pakta me shumë besim ndër qytetarët sot, Megjashi është sinonim i të drejtave dhe mirëqenies së fëmijëve.

Vite të tëra është një nga organizatat e njohura për qytetarët , por edhe partner i përkushtuar i organizatave dhe nismave të shumta qytetare, rrjeteve, institucioneve publike, mediave dhe kompanive nga vendi dhe jashtë.

Megjashi është e njohur për numrin e madh të aktiviteteve, organizatë e cila është e zëshme për çështjet më të zjarrta sociale që prekin fëmijët.

Organizatë e pavarur nga partia, me pasqyrë të qartë të problemeve dhe nevojave sociale, falë shërbimeve dhe përbërësve të saj, është gjithmonë e gatshme që t'u përgjigjet të gjitha sfidave dërrmuese, pavarësisht nga portofoli aktual i projektit.

## Kontakt:


02/2465-316-Megjashi
071-399-079-QZHK shërbimi
070-390-632-AloBushavko

www.childrensembassy.org.mk
info@childrensembassy.org.mk
Rruga: Kosta Novakoviq 22a




*Të gjitha idealet e kësaj bote nuk i vlejnë lotët e një fëmije*

*F.M.Dostoevski*

# Arritjet dhe angazhimet e rëndësishme organizative:

**1. AloBushavko 070 390 632** linjë për ndihmë dhe mbështetje për fëmijë dhe të rinj me **32.683 raporte në 29 vite ekzistencë dhe funksionim**




**2. Mbi 1.500 artikuj në shtyp dhe 1.826 raporte** televizive dhe paraqitje në media **për përfaqësimin e të drejtav e të fëmijëve** në publik dhe para institucioneve (reagime, intervista, debate...)

- **Përfaqësimi i të drejtave të fëmijëve në rrugë dhe fëmijëve të rrugës** (Qendra ditore për fëmijët që nuk ndjekin shkollën gjatë viteve 2005-2015; Strategjia dhe plani i veprimit për të drejtat e fëmijëve dhe mbështetje për fëmijët në rrugë/fëmijët e rrugës, shërbimi për rroba të dorës të dytë që është i disponueshëm për më shumë se 15 vjet për familjet më të rrezikuara).
- **Përfaqësimi i fëmijëve për ambient jetësor të shëndetshëm dhe ajër të pastër** (reagime, postime, protesta para Drisla, Usje, Qeverisë, në lokacione të ndryshme në Shkup dhe në shumë qytete të Maqedonisë)
- **Përfaqësimi për sanksione më të mëdha për pedofilët** para opinionit dhe institucioneve me masa të miratuara për kastrim kimik për përsëritësit e veprave.
- **Përfaqësimi i të drejtave të fëmijëve pa prindër** të drejtat e fëmijëve për të njohur prindërit e tyre biologjik përmes mbështetjes së Aksionit të organizatës KLIK.
- **Përfaqësimi për ndryshimin e ligjit për familje** nëpërmjet mbështetjes së iniciativës për Prindërim të përbashkët dhe të përgjegjshëm pas divorcit.






**3. Arsimi paqësor** si program dhe aktivitet që mobilizon, trajnon dhe bashkon mbi 150 profesorë-e në 6 qytete të Maqedonisë













## 4. Mbrojtja e fëmijëve nga konfliktet ushtarake dhe fatkeqësitë e tjera

- Lufta në Jugosllavi në vitin 1992-apel për kujdesin ndaj fëmijëve të prekur nga lufta - mbi 60.000 nëna dhe fëmijë janë evakuuar dhe përkujdesur në Maqedoni.
- Kriza në Kosovë-puna në 5 kampe për të ndihmuar fëmijët e prekur nga lufta.
- Konflikti në Maqedoni në vitin 2001-hapja e strehës për përkujdesjen e 16 personave të zhvendosur brenda vendit.
- Lufta në Siri dhe punëtori me fëmijët refugjatë në kampet e Tabanovcit.
- mbi 500 fëmijë u përfshinë në kampet verore për mbështetjen e fëmijëve të prekur nga lufta.
- Vërshime të mëdha në vitin 2016 në disa fshatra në Shkup-Stajkovc, Singeliq, Araçinë dhe Smilkovc.

MEGJASHI së bashku me vullnetarë, pediatër dhe, dermatologë ndihmuan fëmijët në zonat e përmbytura, 15 ditë, për aq kohë sa zgjati gjendja e jashtëzakonshme.









## 5. Raporte alternative

- **Raporti alternativ i fëmijëve për situatën e të drejtave të fëmijëve** i është dorëzuar Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës më 30 tetor 2020 dhe është prezantuar në sesionin e 88-të paraprak të Komitetit në shkurt të vitit 2021.
- **Raporti alternativ për situatën e të drejtave të fëmijëve** përgatitur nga Koalicioni Nacional Maqedonas për të Drejtat e Fëmijëve.






## 6. **Promovimi i vullnetarizmit** dhe përfshirja në aktivitete (mbi 1,300 vullnetarë me mbi 700,000 orë pune)














## 7. **Punëtori pa pagesë për fëmijë** ku morën pjesë 2000 fëmijë në periudhën 1994 deri në vitin 2009 dhe mbi 5.550 studentë të përfshirë në aktivitetet e Ambasadës së parë të fëmijëve në botë-Megjashi







*Atë që e kemi bërë për vete, vdes bashkë me ne; Atë që e kemi bërë për të tjerët mbetet e pavdekshme.*

*Albert Pike*



# AloBushavko-telefon për fëmijë dhe të rinj 070 390 632

I njohur më parë si telefoni SOS për fëmijë dhe të rinj, AloBushavko ofron mbështetje psiko-sociale për fëmijë, të rinj dhe të rritur për tema të ndryshme që lidhen me fëmijët. Linja filloi të funksionojë për herë të parë në vitin 1993 si përgjigje ndaj shumë raportimeve për shkeljen e të drejtave të fëmijëve. AloBushavko është shok i fëmijëve i cili është i disponueshëm në çdo kohë për ndihmë dhe probleme të vogla, për dilemat, pyetjet dhe sfidat me të cilat përballen fëmijët dhe të rinjtë. Ekipi i AloBushavko përbëhet nga psikologë, pedagogë, punonjës socialë, mësues dhe vullnetarë. Vazhdimësia e punës në këtë linjë është shumë e rëndësishme për Ambasadën e parë të fëmijëve në botë- Megjashi, dhe jemi shumë të lumtur që me mbështetjen e shumë kompanive, institucioneve dhe qytetarëve, ajo funksionon pa probleme deri më sot.

## Raportimi i të dhënave nga raporti i fundit vjetor për vitin 2021










Tabela 3. Numri i përgjithshëm i fëmijëve-të rinjve të prekur nga problemet për periudhën janar-dhjetor 2021

| Kategoria e problemit | Gjithsej |
|---|---|
| Marrëdhënie familjare | 207 |
| Lëndime | 168 |
| Qasshmëria | 108 |
| Shëndeti mendor | 76 |
| Shkolla | 33 |
| Diskriminimi dhe përjashtimi | 15 |
| Fëmijë të zhdukur | 13 |
| Shëndeti fizik | 10 |
| Seksualiteti | 4 |
| Gjithsej | 634 |

Tabela 1: Fëmijë/të rinj të prekur nga rasti, sipas grupmoshës, të ndarë sipas gjinisë

| Mosha | Meshkuj | Femra | Të pacaktuar | Të panjohur | Gjithsej sipas moshës |
|---|---|---|---|---|---|
| 00-03 | 20 | 27 | 0 | 1 | 48 |
| 04-06 | 29 | 23 | 0 | 0 | 52 |
| 07-09 | 30 | 29 | 0 | 1 | 60 |
| 10-12 | 45 | 21 | 0 | 2 | 68 |
| 13-15 | 27 | 33 | 0 | 2 | 62 |
| 16-17 | 17 | 18 | 0 | 0 | 35 |
| 18-25 | 7 | 4 | 0 | 5 | 16 |
| 25+ | 2 | 1 | 0 | 0 | 3 |
| Të panjohur | 21 | 20 | 0 | 64 | 105 |
| Gjithsej sipas gjinisë | 198 | 176 | 0 | 75 | 449 |

### Kategoritë e problemeve të fëmijëve që janë objekt raportimi për ngjarje









# Reagime publike për mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtave të tyre

Ekipi i Ambasadës së parë të fëmijëve në botë-Megjashi - i ndjek ngjarjet politike dhe publike dhe reagon ndaj raportimeve për shkelje të të drejtave të fëmijëve. Gjatë 30 viteve të funksionimit të saj, ka pasur më shumë se 1.500 shkrime në shtyp, reagime publike dhe mbi 1825 programe televizive, me të cilat është ushtruar presion mbi institucionet për gatishmëri për të vepruar, përgjegjësi, kujdes dhe përkushtim në punën lidhur me fëmijët dhe të drejtat e tyre.




# Shërbim për rroba të dorës të dytë 02/2465-316

Në Ambasadën e Parë të Fëmijëve- Megjashi, prej më shumë se 10 vitesh funksionon shërbimi për ndihmë dhe mbështetje të kategorive socio-ekonomike të cenueshme. Falë donacioneve nga popullata lokale, ne mund të ndihmojmë me veshmbathje dhe këpucë për ata që kanë nevojë. Brenda një muaji, ky shërbim gjeneron 20 donacione me veshmbathje dhe këpucë, ndërkaq rreth 100 persona për çdo muaj vijnë dhe zgjedhin nga veshmbathjet dhe këpucët e dhuruara. Në vitin 2021 në kuadër të këtij shërbimi ka pasur donacione me prodhime furre falë donacioneve të ofruara nga burektorja Vatasha dhe furra Bredvej.




# Sektori për hulumtim të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë

I njohur më parë si sektori i promovimit dhe qëndrueshmërisë ose sektori i mbledhjes së fondeve, sot aktivitetet kryesore janë të fokusuara në zhvillimin dhe qëndrueshmërinë organizative. Sektori ka zhvilluar strategji për qëndrueshmërinë financiare të viteve 2022-2024 në të cilën përcaktohen aktivitetet dhe qëllimet e ardhshme të sektorit. Në kuadër të sektorit është zhvilluar një plan biznesi, qëllimi i të cilit është zhvillimi i ndërmarrjes sociale.








## Fushat kryesore që kanë nevojë për mbështetjen tuaj

1. **Linja AloBushavko për ndihmë dhe mbështetje për fëmijë dhe të rinj.** Dhuroni për mbështetje të vazhdueshme 24 orëshe për fëmijët dhe të rinjtë.
2. **Përfaqësimi për të drejtat e fëmijëve** dhe ndjekja e situatës me të drejtat e fëmijëve, reagimet ndaj politikave dhe praktikave që janë në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës. Dhuroni për gatishmëri për të vepruar dhe mobilizim edhe më të madh.
3. **Shërbim për mbështetjen e personave me status të ulët socio-ekonomik**, rroba të dorës të dytë, ushqim, materiale edukative... Dhuroni për të siguruar një numër më të madh donacionesh dhe për t'i shërbyer një numër i madh përdoruesish.
4. **Sipërmarrja sociale** (zhvillimi i sektorit për hulumtim, zhvillimit dhe qëndrueshmërisë dhe përfshirja e kategorive të cenueshme në punë ).Këtë muaj pra, nëntor 2022, sektori fillon me angazhimin e punësimit të kategorive të cenueshme. Dhuroni për zhvillim më të shpejtë dhe përfshirje më të madhe.
5. **Kushte te mira pune.** Dhuroni për sanimin e ndërtesës dhe ambienteve të punës ku punon ekipi i APFB Megjashi.
6. **Fondi i krizës për intervenime urgjente**, zjarre, përmbytje, tërmete dhe fatkeqësi të tjera - Dhuroni në fondin e krizës për mobilizim të shpejtë si dhe përdorim i duhur i fondeve.
7. **Mbështetje e përgjithshme për punën e plotë të organizatës**

**Misioni i Ambasadës së Fëmijëve - Megjashi** është të përfaqësojë dhe mbrojë të drejtat e fëmijëve, të inkurajojë prindërimin e përgjegjshëm dhe respektimin e personalitetit të fëmijëve, të forcojë lëvizjen civile për të drejtat e fëmijëve, pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të avokojë për funksionimin e institucioneve në interesin më të mirë të fëmijës. Megjashi promovon arsimin paqësorë, zhvillimin e qytetarisë aktive bazuar në parimin e jodhunës dhe kultivon diversitetin dhe mundësitë e barabarta për të gjithë.

## Mënyra për donacion ose mbështetje për ndonjërën nga fushat kryesore

1. **Butoni i donacionit -** www.childrensembassy.org.mk mbështetje e punës së përgjithshme të Megjashit
2. **Blej produkt -** www.bushavko.mk - mbështetje e punës së përgjithshme të Megjashit
3. **Kuti donacionesh** të vendosura në markete - mbështetje e punës së përgjithshme të Megjashit
4. **Me plotësimin e formularit për mbështetje -** Mbështetje konkrete në cilëndo nga fushat e përmendura më parë duke e dërguar në adresën tonë të emailit iro@childrensembassy.org.mk
5. **Donacion për veshmbathje dhe këpucë, ushqim dhe produkte higjienike apo mjete shkollore** direkt në ambientet e APFB Megjashi.
6. **Bëhuni mbështetësi ynë** i rregullt me pagesa mujore duke plotësuar formularin dhe ta dërgoni në adresën tonë të emailit iro@childrensembassy.org.mk
7. **Lloj tjetër donacioni**

**Uebfaqja e Megjashi**
**www.childrensembassy.org.mk**

**Uebfaqja e AloBushavko**
**www.bushavko.mk**

**Linja AloBushavko**
**https://alobushavko.mk**

# FORMULAR PËR MBËSHTETËSIT E AMBASADËS SË PARË TË FËMIJËVE NË BOTË-MEGJASHI

Kontakti: ☐ Personi fizik ☐ Personi juridik (biznis, organizatë)

..........................................................................................................................................
(Emri) (mbiemri) ose emri i organizatës , nëse është person juridik:

..........................................................................................................................................
Posti:

Adresa: ..............................................................................................................................
(qyteti) (shteti/vendi) (numri i postës)

Telefon: ................................................... email adresa: ..................................................................

Me donacionin tuaj do të bëheni pjesë e murit të njohjes së donatorëve (në euro)

☐ Mbi 500, oo ☐ Mbi 1.000,oo ☐ Mbi 3.000,oo ☐ Mbi 5000,oo
☐ Mbi 10.000,oo ☐ Mbi 30.000, oo ☐ Donator i ri

Dëshiroj të jap donacion prej ☐ $ ☐ € ose ☐ denarë.........................(me fjalë)...............................................
Të cilën do ta plotësoj një herë ☐ ose për një periudhë prej ☐ 1 vit ☐ 2 vjet ☐ 3 vjet

Fillimi i (datës-viti)............................................

☐ një herë ☐ mujor ☐ tremujor ☐ gjashtëmujor ☐ vjetor

Pagesa ☐ bankare pa para të gatshme ☐ Tjetër: ......................................................................................
(Ju lutem speficikoni-përmendni)

☐ Dëshiroj të mbetem anonim/anonime

☐ Dëshiroj të paraqitem me emrin e mëposhtëm....................................................................................

**DËSHIROJ QË DONACIONI IM TË MBËSHTESË:**

☐ Të financoj punën e linjës AloBushavko për fëmijë dhe të rinj;

☐ Të financoj përfaqësimin e të drejtave të fëmijëve;

☐ Të financoj funksionimin e shërbimit për mbështetjen e kategorive të cenueshme;

☐ Të financoj zhvillimin e sipërmarrjes sociale dhe përfshirjen e kategorive të cenueshme në punë;

☐ Të financoj rinovimin e ndërtesës dhe ambienteve ku punon ekipi i Megjashit;

☐ Të financojë realizimin, promovimin dhe mbështetjen e organizatës, për të përmbushur nevojat dhe qëllimet e saj të deklaruara dhe të përcaktuara publikisht ose për të zgjidhur probleme të caktuara, në përputhje me statutin, planin dhe programin e organizatës.

☐ Tjetër:.............................................................................................................................................
**(shkruani dëshirën tuaj)**

☐ Pajtohem që të dhënat e mia personale do të përdoren ekskluzivisht për zbatimin e donacionit përmes marrëveshjes për donacion të specifikuar në formular dhe për asnjë qëllim tjetër.

**JU FALËNDEROJ PËR KOHËN QË NDATË DHE DONACIONIN TUAJ**

**Për pyetje lidhur me formularin mund të paraqiteni në numrin e telefonit 071-399-079 ose shkruani në email adresën iro@childrensembassy.org.mk**